

Qyteti im

Falas



Projekti për Zonën Këmbësore në fokusin qytetar

UTICA College gjithmonë e më e pranishme


Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë "Sotir" në Korçë



KORÇA KU

DUA TE JETOJ

Projekti për Zonën Këmbësore në fokusin qytetar



Kthimi i Bulevard Shën Gjergjit në Zonë Këmbësore, synon krijimin e një hapësire publike me të gjithë diversitetin e jetës qytetare dhe është cilësuar si projekti më i rëndësishëm i Bashkisë së Korçës për vitin 2008. Me sloganin “Më shumë hapësirë për qytetarët!”, Bashkia Korçë i ftoi të gjithë të bëhen pjesë e vendim-marrjes në këtë projekt madhor. Në ambjentet e Muzeut të Arsimit, për disa ditë u afishuan dy variantet e projektit për Zonën Këmbësore të realizuara nga studiot e arkitektëve Aleko Papakozma dhe Vladimir Bregu. Specialistë të urbanistikës shpjeguan për qytetarët e interesuar, detajet e projekteve duke mbledhur nëpërmjet sondazheve edhe mendimet dhe sugjerimet e tyre. Këto sugjerime do të merren në konsideratë në hartimin e projektit final të Zonës Këmbësore duke kënaqur kështu shijet dhe kërkesat çlodhëse dhe argëtuese të të gjithë dimensionit qytetar. Në prononcimin publik,

Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi ka theksuar se ndërtimi i Zonës Këmbësore do të shoqërohet dhe me një ndërhyrje radikale në të gjitha objektet duke i kuruar ato nga ana arkitektonike por edhe nga ana funksionale.

Bashkia Korçë në buxhetin e vitit 2008 ka planifikuar 35 milion lekë, ndërkohë që vlera totale e investimit për shndërrimin e këtij bulevardi në shëtitore parashikohet të arrijë në 700 deri 800 mijë euro.

Në jetë të gjithë pyesim PSE?

Sot ne ofrojmë diçka tjetër,

ofrojmë një projektide dhe

ngremë pyetjen PSE JO?!



Design Charette, një praktikë e re

Hapi tjetër që do të pasojë këtë iniciativë do të jetë “Design Charette”, një praktikë e përdorur në promovimin e Zonave Këmbësore në Europë, e që aplikohet për herë të parë në vendin tonë. Persona kompetentë në fushën e projekteve urbane, si edhe të tjerë që kanë njohuri në këtë fushë, do të propozojnë konkretisht me anë të dizenjimit disa zgjidhje të mundshme, të cilat do të ndihmojnë në hartimin e projektit final.



SONDAZHI

Qytetarët janë pyetur:

- + Sa e vlerësojnë projektin e ndërtimit të Zonës Këmbësore?
- + A duhet të përfshihet në Zonën Këmbësore sheshi para Katedrales?
- + A janë dakord ata për ndërtimin e një nënkalimi?
- + Çfarë problemesh mund të sjellë kjo zonë në këtë pjesë të qytetit?
- + Çfarë ambientesh e shërbimesh mendojnë ata se duket të ketë më shumë në këtë zonë?

Pas një përpunimi paraprak të sondazheve, rezultoi se pjesa më e madhe e qytetarëve e kanë përkrahur këtë iniciativë të Bashkisë Korçë duke iu përgjigjur pozitivisht mjaft pyetjeve të tij dhe njëkohësisht kanë bërë mjaft sugjerime konkrete. Pas përpunimit të plotë, rezultatet përfundimtare të këtij sondazhi do të publikohen në numrin e ardhshëm të revistës.



Bonifikimi i fushës së mbetjeve, së shpejti një realitet

Fusha ekzistuese e depozitimit të mbetjeve urbane është cilësuar si mjaft problematike për ndotjen e ambientit dhe shëndetin human. Rehabilitimi i saj ka qenë vazhdimisht në vëmendjen e Bashkisë Korçë, ndaj me kërkesën e saj, nga Ministria e Punëve Publike dhe Telekomunikacionit, u akordua fondi prej 20 milion lekësh për kryerjen e studimit dhe hartimin e projektit për bonifikimin e kësaj fushe. Qendra Kombëtare e Lëvizjes Ambientaliste e cila fitoi të drejtën për të hartuar projektin, brenda 5 muajsh do ta bëjë këtë studim, që do t'i hapë rrugën zbatimit konkret të tij. Aktualisht fusha përpunon 74 tonë mbetje të ngurta në ditë në një sipërfaqe e cila është zgjeruar mjaft, nga 3 ha në gati 5 ha dhe po vazhdon të zgjerohet edhe më tepër, duke dalë jashtë kontratës, duke rrezikuar në këtë mënyrë mjedisin dhe shëndetin.

Paralel me këtë po punohet për projektin e ndërtimit të landfillit të ri rajonal. Në fillim të qershorit, do të organizohet mbledhja e parë e Asamblesë së Kompanisë së Menaxhimit të Mbetjeve.

Prishja e ndërtimeve pa leje u hap rrugën investimeve të reja

Aksioni i Inspektoriatit Ndërtimor dhe Urbanistik pranë Bashkisë së qytetit, ku u prishën katër ndërtime pa leje, do t'i hapë rrugën investimit të Bashkisë në bllokun Shën Mëria dhe 1 Maji për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e të gjithë zonës. Ky investim kap vlerën 38.5 milion lekë. Aktualisht po punohet në rrugën 1 Maji.



Viti 2008, 20 milion lekë më shumë të ardhura

Kriza globale që ka përfshirë ekonominë ndihet mjaft edhe në Korçë. Kjo reflektohet edhe në mbylljen e një numri të konsiderueshëm biznesesh. Është ky një faktor që krijon vështirësi në realizimin e të ardhurave nga bizneset, të cilat bashkia i konverton në shërbime për qytetarët dhe investime publike.

Gjithsesi janë 210 subjekte të reja që kanë çelur aktivitetin e tyre gjatë 4 –muorit të parë të vitit 2008. Janë kryesisht subjekte tregëtare të mallrave industriale dhe ushqimore si dhe bar-bufë dhe më pak shërbime apo profesione të lira. Nga ana tjetër Bashkia po përballlet me një tjetër vështirësi që është identifikimi i adresave të bizneseve të reja të cilët regjistrojnë aktivitetin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ndaj për një koordinim më të mirë të punës kryesisht në drejtim të shkëmbimit të informacionit, Bashkia do të marrë pranë zyrave të saj QKR.

Pavarësisht këtyre, si rezultat i një koordinimi të mirë të punës të Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Korçë është bërë e mundur që të ardhurat si 4-mujor të realizohen në masën 37% të planit vjetor. Në total realizimi i të ardhurave shkon në 131 milion lekë ose 20 milion lekë më shumë se në vitin 2007. Peshën më të madhe në këtë tejkalim e zë tarifa e pastrimit me 10 milion lekë, tarifë reklame e taksë ndriçimi me nga 3 milion lekë sejcila si dhe tarifë gjelbërimi e tarifë regjistrimi për bizneset e reja përkatësisht me 2 milion e 1,5 milion lekë. Edhe niveli i taksave dhe tarifave familjare ka pasur rritje krahasuar me 2007-ën, nga 5,3 në 9,2 milion lekë.

Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Korçë, krahas punës për regjistrimin e subjekteve të reja, një vëmendje të veçantë po i kushton arkëtimit të debitorëve të prapambetur, veçanërisht arkëtimit të detyrimeve të subjekteve të biznesit të madh dhe lojrave të fatit.




Për herë të parë Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë “Sotir” në Korçë”

Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë për të Rinj “Sotir”, ka qenë një ngjarje e shënuar për qytetin e Korçës. Ishte hera e parë që një konkurs i këtyre përmasave u zhvillua nën siglën e fotografit të madh korçar Kristaq Sotirit. Iniciativës së Qendrës Kulturore “Lindart” iu bashkangjiti edhe Bashkia e Korçës, e cila me këtë aktivitet shënon përpjekjen e dytë për promovimin e kësaj figure pas botimit të Kalendarit 2008, me foto të përzgjedhura të tij. Ky aktivitet nderon njëkohësisht vendlindjen e fotografit të mirënjohur, Korçën e cila gjithmonë ka një hapësirë ku kultura dhe arti promovohen në mënyrë të vazhdueshme.

Ekspozita në fjalë, synoi të reflektonte mbi historinë, faktet që e vërtetojnë atë, si dhe mbi mënyrën e ndikimit të tyre tek artistët dhe realitetet bashkëkohore. Ishin 19 fotografë të rinj nga vende të ndryshme të botës, të cilët konkuruan për çmimin “Sotir”.

Pas prezantimit të punimeve për të pranishmit juria shpalli fituesit e edicionit të parë.

Me çmim të parë u vlerësua seria e fotografive të emërtuara “Vetmi” të fotografes belge Itsasne Casas; me çmim të dytë është vlerësuar fotografia shqiptare Ornela Kuka me cilkin “Pa titull”. Një çmim është dhënë edhe nga Shoqata e Artistëve Figurativë Korçarë të cilët kanë vlerësuar ciklin e titulluar “Krenar të jesh në hije” nga Sonila Bardhoshi.



Serenatat korçare nën një interpretim ndryshe

Më 17 maj, Qendra Kulturore “V. Mio” me mbështetjen e Bashkisë Korçë organizoi edicionin e dytë të Koncertit “Zërat e Serenatës”.

Këtë herë, serenata korçare ka ardhur për publikun e zgjedhur nëpërmjet zërit të sopranos Zhuljeta Sheremeni dhe të riut Gjergji Mani, por edhe këngëtarëve të ftuar nga Tirana, të mirënjohurës mexosoprano Vikena Kamenica dhe tenorit të Teatrit të Operas dhe Baletit Aleksandër Rrapi.

12 këngët më të bukura të serenatës të kënduara me mjaft mjeshtëri herë solo e herë duet e trio u duartrokitën nga publiku. Koncerti Zërat e Serenatës tregoi edhe një herë se pavarësisht nga mënyra e të kënduarit serenata korçare mbetet mjaft e dashur për të gjithë. Këngët u përzgjedhën dhe u orkestruan nga kompozitori Josif Minga.




Ekspozita e piktores ruse Tatjana Vavrzhina

Piktorja ruse Tatjana Vavrzhina çeli ekspozitën e saj të parë në qytetin e Korçës. Piktorja është mjaft e njohur në rrethet artistike ruse dhe europiane, shumë punë të saj janë pronë e koleksionistëve. Në pikturat e Vavrzhinës shquhet admirimi i botës sonë me të vërtetë të pafund. Kjo botë që hapet herë më kontrastet e natyrës herë me fantazmagorinë e qyteteve e herë me larminë e fytyrave e karakterit njerëzor e cila hyn në krijimtarinë e Tatjanës si poezi gëzimi e frymëzimi. Gjuha e saj artistike që i përket shkollës ruse të Shek XVIII, ishte sa ruse aq edhe europiane.

Tafil Peci rikthehet në Korçë

Tafil Peci, fituesi i Konkursit të Parë Ndërkombëtar “Vangjush Mio” të zhvilluar në Korçë vitin e kaluar i rikthehet qytetit me një ekspozitë vetjake. Në ekspozitën e tij të parë vetjake në qytetin e Korçës ai shoqërohej nga miku tij fotograf, kosovari Besnik Hasanaj, i cili ekspozoi së bashku me piktorin, disa fotografi nga koleksioni i tij. Mjeshtëria e grafikës bashkëkohore e piktorit Peci, një gjini kjo jo shumë e lëvruar nga piktorët shqiptarë e gërshetuar me fotot e Hasanaj, të cilat e marrin subjektin jo vetëm nga situata e trazuar politike në Kosovë, por edhe nga resurset kulturore të qytetit të Mitrovicës, deri në konceptimin abstrakt të ngjarjeve historike, ngjallën interesimin e publikut të zgjedhur. Punët e dy autorëve u vlerësuan si për përmbajtjen ashtu edhe për nivelin artistik. Ekspozitën e dy autorëve e shoqëronte edhe ish Kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi, aktualisht Kryetar i Bashkisë së Mitrovicës.



Vrame, Petropulo e Tome së bashku në një koncert instrumental

Koncerti i trios muzikore Vrame, Petropulo, Tome spikati për interpretim dhe konceptim e muzikal duke vënë në dukje të veçantat e vlerat stilistike të dy kompozitorëve Bethoven e Mendelson, të cilët i përkasin dy epokave të ndryshme. Pianisti Koço Vrame, i cili shquhet për virtuozytetin e tij dhe aktivitet të gjerë koncertor brenda dhe jashtë vendit, këtë herë interpretoi së bashku me Jorgo Petropulo në violinë dhe Spiro Tome në Violonçel.

Trishtimi i Zonjës Shnajder

Regjizori i mirënjohur korçar Pirro Milkani i dhuron qytetit të lindjes premierën e filmit “Trishtimi i Zonjës Shnajder”. Një film me nota autobiografike që krijoi emocione të veçanta për publikun e pranishëm. Filmi ishte një bashkëproduksion i suksesshëm shqiptaro-çek ku interpretojnë aktorë të njohur, ndërmjet tyre edhe Mikele Plaçido.



Poetika e peisazhit dhe nudove në pikturën e Karanxhës

Roland Karanxha, piktori i dashurisë dhe bukurisë femërore, i njohur për nudot e tij, vjen ndryshe për artdashësin. Këtë herë frymëzimin e tij piktori e gjen tek Korça, ndaj në ekspozitën e çelur pranë Qendrës Kulturore “V.Mio”, krahas nudove, të cilat mbartin në vetvete syrin mashkullor, apo “syrin e djallit” nën një konceptim filozofik, një pjesë të madhe të tablove të tij e zenë bukuritë natyrore e rrugicat e kalldrëmta të qytetit. Kanë qenë 50 piktura kryesisht të përmasave të mëdha, të punuara në teknikën e akrellkut, me fakturë të ashpër, por që mjaft mirë kanë transmetuar poetizimin e peisazhit dhe të nudove, të cilat ngjallën interesin e vizitorëve.

Nikola e Paola Kondakçi sjellin kompozitorët e mëdhenj francezë në Korçë

Nikola e Paola Kondakçi, vëlla e motër, me një aktivitet të spikatur muzikor e akademik, Nikola në Tiranë në orkestrën e muzikës së dhomës të Akademisë së Arteve dhe Paola si pedagoge dhe Koncertmaestre në Konservatorin Shtetëror të Athinës, vijjnë me një koncert të përbashkët në Korçë. Në repertorin e tyre me veptra të kompozitorëve francezë, Debussy, Franck e Ernest, të cilat konsiderohen të një shkalle vështirësie mjaft të lartë spikati virtuozyteti, profesionalizmi dhe harmonia.



Çamarrokët

Shfaqja teatrale “Çamarrokët” u realizua dhe u shfaq për fëmijët e ciklit 9- vjeçar si një bashkëpunim i Teatrit “Çajupi” dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Mihal Grameno”. Premiera zgjoi interesin dhe dashurinë e fëmijëve për teatrin. Kjo edhe për faktin se krahas aktorëve profesionistë, interpretuan edhe aktorët e vegjël të kursit të aktrimit të çelur pranë QKF “Mihal Grameno”. Shfaqja me skenografi të Roland Karanxhës, formulim muzikor të Pirro Gjatës e koreografi të Blerta Belliut, u shkrua e u vu në skenë nga Naum Tërova.

“Pamje nga ura”, sukses që përsëritet

Për tre netë me rradhë artdashësi korçar ndoqi me interes dramën “Pamje nga ura”. Personazhet e dramaturgut Artur Miler folën për të tretën herë në skenën e Teatrit “Andon Z.Çajupi”.

Me regji të Albert Mingës dhe nga një kast aktorësh të njohur si Timo Flloko, Yllka Mujo, Bujar Asqeriu, Fatos Sela, Indrit Çobani, Olta Gixhari, vepra e dramaturgut Miler u mirëprit edhe një herë nga publiku në skenën e Teatrit “A.Z.Çajupi”, aty ku 44 vjet më parë regjizori Pirro Mani i sapokthyer nga studimet në Institutin Shtetëror të Artit Teatror në Moskë, aty ku 44 vjet më parë regjizori Pirro Mani i sapokthyer nga studimet në Institutin Shtetëror të Artit Teatror në Moskë, e vuri dramën për herë të parë në skenë, ndërkohë që shfaqja rivihet për të dytën herë në skenë nga trupa e Korçës në vitin 1993 nën regjinë e Dhimitër Orgockës. “Pamje nga ura” është historia e emigrantit siçilian Edi Karbone në Nju Jork, i cili duke patur një jetë të pasigurt rrezikon familjen, miqësinë apo edhe fqinjësinë. Ai turbullohet nga pasionet e ndaluara që e çojnë në një fund tragjik. Interesimi i publikut ndër vite tregon për suksesin e garantuar të kësaj drame.



Skënder Rusi - liriku i dhimbjes së bukur

“Jetoj në një qytet në formë zemre
Ku kitarat netëve marrohen,
Ku djemtë nuk rrinë pa ta shkelur syrin
Por edhe vajzave i'u pëlqen të ngacmohen.”

Skënder Rusi

Korçës një fjalë dashurie, - kjo ka qenë poezia me të cilën liriku korçar Skënder Rusi ka çelur për publikun krijimtarinë e tij disavjeçare, në spektaklin poetik të titulluar “Liriku i dhimbjes së bukur”.

50 lirikat më të mira të përzgjedhura me kujdes nga fondi i krijimtarisë disavjeçare të poetit, kanë marrë zë nën interpretimin e aktorëve të mëdhenj të skenës shqiptare Yllka Mujo, Timo Flloko, Zamira Kita, Ligoraq Riza e poetit pogradecar Kastriot Ramollari. Ato janë përcjellë nën sfondin e muzikës së përzgjedhur po me aq kujdes nga Grigor Çani. Për disa minuta spektatori i pranishëm në sallën e Teatrit “Çajupi” ka udhëtuar brenda shpirtit të poetit duke ndjerë bashkë me të dashurinë, dhimbjen, mallin. Me regji nga Zamira Kita e scenografi nga Roland Karaxha mbrëmja u shoqërua nga dy klipe të realizuara nga Luli Baki si dhe interpretimin në violinë të virtuozyt Nikola Kondakçi. Mbrëmjen e ka përshëndetur edhe Kryetari i Unionit të Shkrimtarëve të Shqipërisë Zyhdi Morava.



Grupi i Korçës vjel 3 çmime në Festivalin e Këngës Popullore Qytetare

Këngët e grupit të Korçës u vlerësuan maksimalisht si nga publiku dhe nga juria, në Festivalin e Këngës Popullore Qytetare të zhvilluar në qytetin e Kavajës gjatë tre ditëve të muajit prill. Në skenën e festivalit, këngët qytetare dhe serenatat korçare me udhëheqës artistik Grigor Çanin e drejtues orkestre Adrian Jorgjin, janë kënduar nga Laxarela, Zhuljeta Sheremeni, Vaso Qirinxhi e Mateus Frroku. Grupi i Qendrës Kulturore "V.Mio" u vlerësua nga juria me çmimin e dytë por ndërkohë janë marrë edhe çmime individuale. Kështu, këngëtarja Zhuljeta Sheremeni u cilësua si interpretuesja me nivelin më të lartë artistik dhe Mateus Frroku, interpretuesi më i ri më i mirë.



Ekspozita-konkurs e Nxënësve të Degës Pikurë, pranë Shkollës Artistike "Tefta T. Koço"

"Mbështetja e Bashkisë për këto talente do të jetë e vazhdueshme, pasi këta nxënës janë ura lidhëse mes brezave që sapo kanë filluar të shpalosin talentin dhe profesionistëve."

Niko Peleshi

Nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë Niko Peleshi, nxënësit e Degës së Pikturës nga Shkolla e Mesme Artistike "Tefta T.Koço", çelën pranë Qendrës Kulturore "V. Mio" ekspozitën me punimet e tyre. Në ndryshim nga vitet e tjera, kjo ekspozitë dalloi për pjesëmarrje dhe nivel të lartë artistik. Në vizionin e Bashkisë Korçë për të mbajtur gjallë e zhvilluar në një nivel më të lartë artin e kulturën, aktivitete të tilla shërbejnë si ambasadorë të traditës dhe kulturës sonë. Kjo ekspozitë-konkurs shpalli edhe fituesit e saj. Juria e kryesuar nga Llazi Sërbo vlerësoi me çmim të parë Lori Lako me ciklin e natyrave të qeta, Erion Suli me autoportret dhe Elvis Meto me vizatim në tush.

5 Maj, nderim në ditën e dëshmorëve

Mbarë Korça përkujtoi me nderim 5 Majin, ditën e dëshmorëve të kombit.

Aktivitetet kryesore kulmuan në Varrezat e Dëshmorëve në kodrat e qytetit ku prehen eshtrat e gati 1 mijë të rënëve. Aty kanë zhvilluar homazhe drejtues të pushtetit lokal, partitë politike, organizatat e veteranëve dhe dëshmorëve dhe familjarë. Nën tingujt e bandës frymore të qytetit u vendosën buqeta dhe kurora me lule prane Monumentit "Partizani".

Ekzekutimi i hymnit kombëtar, shënoi mbylljen e ceremonisë, për të vijuar me vizitat në shtëpitë e të rënëve.



Basketboli për meshkuj në Ligën Superiore Skuadra merr vlerësimin e Bashkisë

Ekipi korçar i Basketbollit për Meshkuj në Kategorinë A2 u shpall fitues i Kampionatit Kombëtar, duke hyrë kështu automatikisht në Ligën Superiore A1. Kjo arritje e basketbollistëve korçarë vlerësohet si rezultati i parë konkret i strategjisë së re të Klubit Shumësportësh "Skënderbeu" e mbështetur nga Bashkia e Korçës, e cila ndër të tjera synon të rinovojë sportin korçar me talente të reja duke rritur cilësinë sportive. Është për t'u vlerësuar moshën mesatare të ekipit, e cila është është përgjysmuar duke shkuar në 21,5 vjeç.

Duke e vlerësuar këtë arritje, si fillimin e ngritjes sportive të shumësportëshit pas riorganizimit, Kryebashkiaku i Korçës Niko Peleshi i ka prituri në një takim të veçantë lojtarët dhe trajnerin e ekipit Ilir Nika,



i cili ka një meritë të veçantë pasi ka sjellë pranë ekipit emra të njohur të basketbollit si Renaldo Kacori, Eni Jakova e Mikel Sërbo që i janë rikthyer pas 7 vitesh Skënderbeut pas angazhimit dis-avjeçar me ekipet e Dinamos, Partizanit dhe Tiranës. Në vlerësim të tyre, Këshilli Bashkiak i qytetit miratoi edhe një shpërblim financiar prej 100 mijë lekësh.



Elsa Ballauri tek "Qyteti im"

Suksesi i të gjitha punëve është dashuria...

Elsa Ballauri është gazetare dhe poete e njohur. Që nga viti 1996 ajo drejton Grupin Shqiptar të Drejtave të Njeriut një nga organizatat e para dhe më të rëndësishme që vepron në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Suplement



**Elsa Ballauri
tek "Qyteti im"**

Qyteti im: Sa të afërt e ndjen veten Elsa Ballauri me qytetin e Korçës edhe pse është lindur larg këtij qyteti?

Elsa Ballauri: Asnjëherë njeriu s'e përcakton dot lindjen e vet. Kjo është e lidhur me fatet e paraardhësve. Fati i i shpërnguli prindërit e mi nga Korça dhe i shpuri në Tiranë. Ishte periudha e pas Luftës së Dytë Botërore. Familjet e prindërve të mi, prindërit e tyre edhe ata vetë u ndjenë të rrezikuar në Korçën komuniste të pas luftës. Pavarësisht se shpesh nuk na pëlqen të japim epitete jo aq të këndshme, them Korçën komuniste duke iu referuar te gjithë periudhës pas lufte në Shqipëri, ku i gjithë vendi u ndikua nga një përmbysje e madhe sociale e politike që shkaktoi shumë vuajtje të ardhshme. Duke pasur një origjinë prej familjesh të pasura, paraardhësit e mi u ndjenë të ndjekur dhe pasi gjyshi im, Angjeli Ballauri u dënua si armik i popullit në burgun e Maliqit, im atë, Roberti e pati më të lehtë të vazhdonte jetën e tij në Tiranë, ku anonimati i tij, në njëfarë mënyre do ta shpëtonte nga trysnia anti-borgjeze e Korçës. Gjithmonë e më shumë, tani e kuptoj edhe vetë se sa të vështirë e ka pasur ai të largohet nga qyteti i tij. Këtë e ndjej shumë mirë, se e di që dashuria e prindërve për qytetin e tyre më ka bërë edhe mua ta dua kaq shumë Korçën.

Qyteti im: Si e keni parë gjithë këto vite Korçën në aspekte të ndryshme të zhvillimit ?

Elsa Ballauri: Jam trishtuar shumë pas viteve '90. Dikur, duke lënë mënjanë pakënaqësitë dhe inatin që kishim me pushtetin e kaluar, gjithsesi e shihja Koçën një vend i cili nuk mund të kritikohet dot. Nuk e them këtë për Tiranën. Tirana, ku jam lindur, ishte qyteti i zakonshëm që meritonte edhe dashurinë, edhe urrejtjen. Ndërsa Korça për mua ishte një vend gati ideal, çdo gjë ishte dhe duhej të ishte perfekte... Por pas viteve '90 kur njerëzit iknin, kur ndodhnin krime të shëmtuara si në çdo qoshe tjetër të Shqipërisë, kur gjërat liheshin pasdore, Korça po bëhëj e zakonshme dhe kjo më dhimbte. Por mesa duket ajo dashuria e vjetër dhe e pandryshueshme për atë qytetin ideal rrinte e fshehur brenda meje, dhe kur Korça nisi të rimerre frymë, unë përsëri u riktheva për ta gjetur. Një rol të jashtëzakonshëm ka luajtur familja , prindërit, daja im që jeton në Korçë, dashuria me njerëzit e fisit tim. Por mbi të gjitha, im atë, im atë, Robert Ballauri, nuk ishte vetëm një Korçëdashës, ai ishte ishte një intelektual i formuar që e dinte mirë se si mund ta ndihmonte qytetin e tij. Diskutimet me të mbi historinë e qytetit, idetë që kishte për të përmirësuar shumë aspekte, sidomos kulturore dhe historike, kujtimet e bukura dhe nostalgjike për ngjarjet e familjeve të mëdha korçare, për njerëz që i ishin dedikuar Korçës, për mua kanë qënë një ngacmues sistematik për të më mbajtur gjallë interesin për qytetin... Sikurse thashe, 10 vjetët e fundshekullit, ishin të rënda. Qyteti s'ishte ai që desha të gjeja dhe unë i rrallova vizitat. Vetëm se nuk mund ta harroj që në çdo udhëtim, pavarësisht nga problemet që kishte qyteti, fusha e Korçës ishte gjithmonë e kujdesur dhe e punuar, ndryshe nga e gjithë Shqipëria e lënë pasdore.

Qyteti im: Cili është motivi i ardhjes suaj të fundit në Korçë?

Elsa Ballauri: Erdha të takoj miqtë e mij të Utica College, New York si dhe Kryetarin e Bashkisë, Z. Peleshi. Duhet të flisnim dhe diskutonim më shumë për të ardhmen e një ideje të re, por shumë interesante për të gjithë ne, hapjen këtu të një Universiteti , degë e Utica College.

Qyteti im: Pse mendoni se qyteti i Korçës e "meriton" hapjen e një universiteti amerikan mbase më shumë se qytetet e tjera në Shqipëri?(Çfarë iu shtyu qe i sugjeruat kolegeve amerikane Korçën?)

Elsa Ballauri: Në përgjithësi, unë e sugjeroj Korçën për çdo gjë. Ajo që më bind për këtë, është se njerëzit janë seriozë dhe punëtorë. Ata e duan qytetin e tyre.

Për mua sukcesi i të gjitha punëve , është dashuria. Aq më tepër Korça është e favorshme në sferën e edukimit. Është një nga traditat e saj më të hershme, më të spikatura. Fenomeni “shkolle” në Korçë, është si fenomeni “serenatë”. Nuk mund të gjej asnjë vend tjetër të cilit mund t’i shkonte shkollimi më mirë se këtu. Shtoi pastaj edhe dashurinë time. Megjithëse, nuk do të bëja asnjë sugjerim nëse s’do të isha e bindur se do të aprovohej. Vendimi im u plotësua pasi bisedova paraprakisht me Kryetarin tuaj të Bashkisë, i cili është një nga njerëzit e veçantë në politikën dhe administratën shqiptare që ka vizione të qarta dhe është i zoti t’i realizojë ato. Jam shumë e lumtur që godina e universitetit do të jetë ajo e ish-Liceut Francez. Është një nga dhuratat-perla që altruisti i madh Thoma Turtulli dha për qytetin. E vlen të rikthim në origjinë.

Qyteti im: Çfarë do t’i sjellë hapja e këtij universiteti Korçës?

Elsa Ballauri: Kam kohë që mendoj se aktivitetet dhe ngjarjet nuk duhet të izoloohen vetëm në Tiranë. Në pretendojmë të kemi zhvillim , duhet të dalim përtej kufijve të kryeqytetit. Unë e shoh hapjen e universitetit si një shans të mirë për të gjetur rrënjët e harruara. Dikur ka pasur një Lice Francez dhe një prezencë të pedagogëve francezë në Korçë, tani do të ketë një Kolegj Amerikan dhe prezencë amerikanësh. Kjo është e mira e komunikimit. Korça do të ketë një jetë kulturore më të pasur, një jetë studentore më të vrullshme, një ardhje të studentëve nga shumë qytete të tjera, madje edhe studentë të huaj. Do të ndjehet më mirë ekonomikisht dhe shpirtërisht.

Qyteti im: Për ta zgjeruar bisedën tej kufijve të Korçës.Ju i jeni kushtuar prej vitesh një çështjeje sa delikate aq dhe të rëndësishme: Të drejtave të njeriut. Pas më shumë se një dekade në krye të GSHDNJ mendoni se Shqipëria ka bërë progres në këtë fushë dhe sa i vlefshëm ka qënë kontributi i organizmit që ju drejtoni krahas faktorëve të tjerë?

Elsa Ballauri: Shqipëria ecën para-mbrapa. Sapo ka dalë një raport i Amnesty International , ku vendi ynë kritikohet për sistem të dobët gjyqësor dhe kushte të këqija të burgjeve. Është për të ardhur keq kur mendoj se objektivat tona për përmirësimin e burgjeve ishin ato te viteve 1991-92. Prandaj më duket kthim prapa. Megjithatë, ajo që është arritur pozitivisht, është se të drejtat e njeriut po artikulohehen si koncept. Shteti ka një pozicion tjetër dhe përpiqet të përbushë disa standarte. Por ende jemi shumë larg respektimit të plotë të tyre. Mendoj se organizata që unë drejtoj si dhe të tjera që punojnë në Shqipëri, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e konceptit të të drejtave të njeriut si dhe në realizimin e shumë sukseseve.

Qyteti im: Në demokracinë e brishtë shqiptare vuan (shqetësohet)më shumë Elsa aktiviste e të drejtave të njeriut,Elsa gazetare,Elsa poete apo Elsa grua?

Elsa Ballauri: Në fakt, Elsa është vetëm një. E rëndësishme është që shqetësohet. Ato ndarje brënda meje vetëm ndihmojnë njëra-tjetrën.

Qyteti im: Hapësirat e lirisë në një perceptim primar dhe teorik duket se janë të pafundme.Në gjykimin tuaj cilët duhet të jenë kufijtë e tyre?

Elsa Ballauri: Në shoqërinë njerëzore, liria nuk mund të jetë e pafundme, ndryshe ajo kthehet në anarki dhe është një boomerang që vjen e na qëllon neve vetë. Për këtë arsye edhe koncepti i lirisë, cilësohet nga filozofia politike në positive dhe negative. Unë mendoj se njeriu është gjithmonë në kërkim të definicionit të lirisë dhe kjo është një nga gjërat më të bukura të tij. Në botën e tanishme moderne janë përcaktuar përmasat dhe kufijtë e lirisë. Ne Shqiptarët i njohim mjaft mirë tashmë, por nuk dimë t’i zbatojmë.

Qyteti im: Cilat kanë rezultuar mënyrat me të efektshme për të rifituar te drejta të shkelura në kushtet e realitetit shqiptar?

Elsa Ballauri: Ndërgjegjësimi qytetar. Ankimi, të ngresh zërin për padrejtësitë që bëhen. Por edhe të dish ku të drejtohesh. Është e rëndësishme gjithashtu të kuptojmë se si mund të bashkëpunojmë dhe t’i kërkojmë të drejtat bashkarisht.

Qyteti im: Duke iu rikthyer përsëri Korçës, qytetit ku bashkëjetojnë fe të ndryshme dhe minoritete .Sa konstruktive iu duket kjo bashkëjetesë në Korçëe më gjerë ne Shqipëri?

Elsa Ballauri: Kur kam ardhur në Korçë për Pashkët, më është thënë që sheshi i madh i ka gjysmat e qytetarëve muslimanë...Kjo është edhe një gjë tjetër e bukur në Korçë. Pavarësisht nga shumë të meta, shqiptarët i ka ndihmuar dhe i ndihmon tolerance fetare dhe e komuniteteve. Personalisht, duke i parë në një mënyrë më profesionale, mendoj se edhe këtu ka vend për t’u diskutuar, por në tërësi nuk është një problem prioritar.

Qyteti im: Do të donit të kishit bërë diçka të ndryshme në jetën tuaj?

Elsa Ballauri: Nuk do të doja diçka ndryshe, do të doja të kisha bërë dhe të bëj shumë më shumë se kaq.....

LAURENCE W.ROBERTS

Profesor i Asociuar i Psikologjisë
Dekan i Asociuar i Arsimit Ndërkombëtar
UTICA COLLEGE UNIVERSITY – USA

**KORÇA,ÇFARË QYTET I BUKUR
PËR TË HAPUR NJË UNIVERSITET!**



Së bashku me pedagogë të tjerë si edhe studentë të Utica College University Prof. Roberts vizitoi për disa ditë qytetin e Korçës për të parë mundësinë e hapjes këtu të një dege të këtij universiteti amerikan .Për revistën “Qyteti im”ai do të shprehej:

Për Korçën kisha dëgjuar vetëm se ishte një qytet i pastër..Teksa diskutonim mundësinë e hapjes të një dege të universitetit tonë në Shqipëri mikësja jonë, korçarja Elsa Ballauri na tha se duhet të ndalonim ta shihnim njëherë Korçën si një mundësi të mirë për realizimin e idesë sonë.Erdhëm këtu dhe u mahnitëm. Pamë entuziazëm,rini,njerëz krenarë për qytetin e tyre ,ldership të fortë me vision të qartë,traditë të hershme kulturore dhe arsimore,rrugë të pastra dhe në fund menduam:Çfarë qytet i bukur për të hapur një universitet! Takuam kryebashkiakun Niko Peleshi dhe na bëri përshtypje fakti se ai kishte një strategji për zhvillimin e qytetit si edhe një interes të veçantë për hapjen e universiteteve këtu.Keni një lider të fortë, me vision të qartë, me të cilin është shumë e lehtë të punosh.

Ne tashmë e kemi vendosur:Deqa e pare nderkombëtare e Utica College do të hapet në qytetin e Korçës.Na mbetet të punojmë për formalizimin e këtij vendimi që do t’i sjellë qytetit tuaj të parin universitet amerikan në Shqipëri. Besoj se vjeshta e vitit 2009 do ta gjejë Korçën me një universitet amerikan sipas vizionit tonë të shtrirë në tre degë marketing ,fizioterapi dhe psikologji.

Së pari ramë në dashuri me Shqipërinë, tani me Korçën!

Qyteti im - Vështrim në kohë

Vijon nga numri i kaluar


Korça ndahej në tre pjesë: Varoshi që ishte në veri-lindje, Kasabaja që ndodheshe në jug-perëndim dhe tregu që ndodhej midis varoshit dhe kasabasë. Varoshi me Kasabanë ndahej me anë të lumit Mborjes (moravës) i cili rridhte nga lindja për në perëndim, duke ndarë tregun në dy pjesë, Varoshi ndodhej në të djathtë e Kasabaja në të majtë.

Qyteti i Korçës ishte i ndarë në myslimanë e ortodoksë. Popullsia myslimane ishte më e pakët në numër, e banonte në pjesën e qytetit të quajtur Kasaba. Ajo përbëhej nga 5 lagje: Lumi, Sahati, Qoshku, Radaneci dhe Kull e hirit. Ajo ushtronte kryesisht bujqësinë (banorët e lagjes Radanec) merrej me administrimin e Vakëfit të Iliaz Mirahorit (Mytevelinjët), ose ishin zyrtarë të administratës së Perandorisë Osmane. Tregu ndodhej midis dy pjesëve Varoshit e Kasabasë. Popullsia e krishterë banonte në lagjen Varosh, ishte e organizuar në Komitetin Ortodoks që drejtohej nga një forum i zgjedhur, dhimojerondia ose këshilli i pleqve. Kjo bëhej sipas ligjeve të shpallura nga sulltan Sulejman Elkanuni.

(1520-1566). Varoshi përbëhej nga 9 lagje: Penço, Manço, Mando, Mano, Qiro, Barç, Barç i vëllehve, E re, e Varosh i poshtëm e lagjja e Shën Mërisë. Jeta kolektive u ndje edhe në ndërtimin e qytetit. Shumë vepra u ngritën me kontributin e përbashkët të popullsisë, si shtrimi me kalldrëm i rrugës nga Kisha e Shën Gjergjit deri në qytet në shek. XVIII, ose ndërtimi i sahatit të qytetit në vitin 1784 nga esnafët e bakenjve myslimanë gegë dhe ortodoksë voskopjarë. Kjo traditë u ruajt deri në shekullin tonë. Për ndërtimet kryesore të karakterit shoqëror, si p.sh. për bibliotekën, për ndërtesa qeveritare kontribuonin persona të veçantë ose mblihdeshin ndihma nga i gjithë populli. Korçarët kishin kuptuar gjithashtu se shkollimi ishte një kusht i nevojshëm për ecjen përpara. Dëshmitë e para për ngritjen e shkollës në Korçë i kemi që në vitin 1724 ku mësimi jepej në gjuhën greke. Në vitin 1738 esnafët e Varoshit (shtatë) morën vendimin për të hapur shkollë që të mësojnë djemtë pa pagesë cilëtdoqfshin. Më 1850 u krijua arka e përbashkët, që njihet me emrin "Llaso e Korçës" me kontributin e gjithë banorëve të komunitetit ortodoks, fondet e të cilës përdorehin për mirëmbajtjen dhe hapjen e shkollave. Në këtë kohë në qytet funksiononin disa shkolla: Gjimnazi (1856), dy shkolla qytetëse (1867), shkolla e vajzave (1857), dy foshnjore (1872 e 1873) që mbaheshin nga fondet e komunitetit ortodoks dhe Ruzhdia (foshnjore), Iptidaje (filllore-1880) dhe Idadia (gjimnazi), në pjesën myslimane që mbaheshin me fondet e qeverisë turke.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

Shënim: Të dhënat historike dhe hipotezat e paraqitura në këtë artikull nuk prezantojnë një qëndrim zyrtar të stafit të gazetës.



Burime:

LIBRAT:

- "Fjalori enciklopedik shqiptar", Tiranë, 1985
- "Korça, në faqet e historisë", Emin Selenica
- "Një faqe historike", Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- "Korça - urbanistika, arkitektura", Piro Thomo
- "Mbi themelomin e Korçës" (broshurë) Arben Gjata
- "Shqipëria më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Shqipëria e ilustruar më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Korça dhe fshatrat përfaqar", Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- "Korça dhe katundet e qarkut" (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- "Historia e Shqipërisë" vëll. II, Tiranë 1965
- "Themistokli Gërmenji", Piro Tako, Tiranë, 1988

GAZETAT:

- (Koleksione pranë Bibliotekës "Thimi Mitko" dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
- "Korça" drejtuar nga Sami Pojani e Lytifi Zavalani, Korçë, 1908-1910
- "Lidhja othodokse", drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
- "Koha" drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
- "E drejta", drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
- "Gazeta e Korçës", drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935



Monumente Kulture



Pazari i Vjetër i Korçës

Vijon nga numri i kaluar

Në shekujt e kaluar pazari ka qenë vendi i shkëmbimeve të tregtarëve që vinin nga Turqia, Greqia, Trieste dhe Venecia. Ai ka qenë i shquar për hanet e vendosur njëri pas tjetrit ku ia vlen të veçohet Hani i Elbasanit dhe Hani i Manastirit të cilët shërbenin si fjetore për njerëzit që vinin nga jashtë qytetit. Tregu me rreth 1.000 dyqane arriti kulmin e tij gjatë fundit të shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit të XX. Në strukturën urbanistike të qytetit, pazari krijonte një ansambël më vete. Të dy pjesët e pazarit që ndaheshin nga lumi, lidheshin me ura të drunjtë, ndërsa rruga kryesore që vinte nga qyteti, e kalonte lumin mbi një urë të gurtë me qemerë, sipër së cilës ngrihen dyqane. Pazari është djegur tre herë por është ndërtuar sërish. Tani pazari vazhdon të funksionojë njëloj si më parë dhe ka vlera historike dhe monumentale.

Hani i Elbasanit

Në zonën e Pazarit të vjetër ndodhet një ndër “hotelet” më të vjetra me emrin Hani i Elbasanit i ndërtuar në shekullin XVIII. Kjo ndërtesë është e stilit otoman, e cila edhe pse është restauruar dhe është kthyer në hotel, ka ruajtur ende fizionominë dhe arkitekturën e atëhershme. Hani i Elbasanit është një ndërtesë dy katëshe, kati i dytë me ballkone të dekoruara prej druri të cilat bien mbi oborr. Oborri i hanit është i shtruar me kalldrëm, në mes të të cilit ndodhet një pus. Në anën e majtë të derës së madhe prej druri ishin shkallët në formë të valëzuar prej guri që të ngjijnin në katin e dytë të hanit. Përveç hanit të Elbasanit ekzistues është edhe Hani i Manastirit. Dikur kanë ekzistuar 16 hane të cilat janë përdorur si vend pushimi për tregtarët që vinin nga larg.





Jetimët, më shumë vëmendje

Më 20 maj, në ditën e jetimëve, e gjithë vëmendja e Bashkisë së qytetit është drejtuar tek fëmijët jetimë të qytetit. 16 fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës në Korçë janë vizituar në shtëpinë e tyre të madhe nga Nënkryetari i Bashkisë, z. Arjan Bejko dhe një pjesë e stafit bashkiak, të cilët me një kontribut modest financiar kanë shprehur solidaritetin e tyre. Njëkohësisht me ndërmjetësimin e Drejtorisë së të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë është siguruar një ndihmë e konsiderueshme nga biznesi në veshmbathje, bebelina, detergjentë të cilat u janë dhuruar këtyre fëmijëve. Në emër të Bashkisë Korçë, Nënkryetari i Bashkisë Arjan Bejko, ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve veçanërisht të qeverisë dhe biznesit për më shumë përkujdesje dhe një dorë të ngrohtë për jetimët.

Këtë ditë e kanë festuar edhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit së bashku me fëmijët e të rinjtë e Qendrës së Zhvillimit Atelje.

Mirela Ciko, Drejtore e Shtëpisë së Foshnjës ka falenderuar për mbështetjen financiare edhe subjektet:
Nesti Vinçani, Mirela Potka, Meltiaz Spahiu, Firma "Elisabet", Alben 2 Security, Firma "Life Care".



Strehimi

Pranë Bashkisë Korçë kanë aplikuar si të pastrehë sipas kriterëve që përcakton Ligji 9232, datë 13.05.2004, gjithsej 1300 familje, nga këto plotësojnë nivelin e të ardhurave me mbi 24 000 lekë në muaj 40% e tyre, ndërsa 60% janë nën këtë nivel, çka tregon se përparësi në ndërtimin e banesave për të pastrehët duhet ta zerë ndërtimi i banesave sociale me qera. Në këtë kategori të të pastrehëve, problem mbetet trajtimi i familjeve të komunitetit egjiptian, rom, familjet që banojnë në shtëpitë e ish pronarëve, personat me probleme shëndeti e në veçanti familjet njëprindërore ku kryefamiljari është grua e ve, ose e divorcuar.

Për të pastrehët, Bashkia Korçë nga viti 2003 e në vazhdim ka vënë në dispozicion 164 apartamente banimi.

Për të pastrehët, Bashkia Korçë nga viti 2003 e në vazhdim ka vënë në dispozicion 164 apartamente banimi

Viti 2003	20 apartamente
Viti 2004	24 apartamente
Viti 2005	40 apartamente
Viti 2007	80 apartamente

Bashkia Korçë është në proces të hartimit të strategjisë 10 vjeçare të strehimit dhe parashikon që në planin afatmesëm 2009-2011 të ndërtojë çdo vit 136 apartamente, nga të cilat me fondet e buxhetit të shtetit 40 dhe pjesa tjetër me financim të kredisë së CEB apo nga burime të tjera edhe 96 apartamente të tjera.



UTICA College *gjithmonë e më e pranishme.*

Përgjatë dy ditëve të muajit maj, në ambientet e Spitalit Pediatrik, fizioterapistë amerikanë me eksperiencë në fushën e ekzaminimeve dhe trajtimeve, Dale Scalise Smith, Mary Jean Gelsamino dhe Laurence Roberts kanë ofruar shërbimin e tyre për më shumë se 70 fëmijë të moshës deri në 18 vjeç nga i gjithë Qarku i Korçës.

Ardhja e tyre u mundësua nga Bashkia e qytetit në bashkëpunim me Utica College –SHBA.

Fizioterapistët amerikanë, njëkohësisht profesorë të Utica College kanë ofruar shërbime për fëmijë prematurë, atletë të dëmtuar, fëmijë me sëmundje muskulare dhe në kocka, dëmtime traumatike, shërbime për fëmijë që hasin vështirësi në mbajtjen e ekuilibrit dhe ecje etj. Krahas vizitave mjekët amerikanë dhanë edhe eksperiencën e tyre për mjekët shqiptarë.

Nëpërmjet këtij shërbimi, Bashkia Korçë ndër të tjera synon që fizioterapinë, këtë shërbim të munguar ta bëjnë prezent në qytetin tonë.

Ky bashkëpunim u zhvillua në kuadrin e marrëdhënieve që po vendosen mes Bashkisë së Korçës dhe UTICA College në SHBA, e cila u pasua me vizitën e 14 studentëve dhe 4 profesorëve të këtij universiteti në qytetin tonë.

Konferenca Ndërkombëtare Studentore në Korçë

Në datat 22 deri 25 Maj u mbajt në Korçë Konferenca e 6-të Ndërkombëtare Studentore e Rrjetit Border Crossing me temë “Duke medituara mbi identitetet ballkanike,- Dinamikat në hapësirë dhe kohë”. Kjo konferencë zhvillohet për herë të parë në Korçë, nën kujdesin e veçantë të Bashkisë së qytetit. Studentë nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia, Sllovenia e vende të tjera të Ballkanit ndoqën leksione nga profesorë të njohur të Universiteteve të ndryshme në të rajonit. Disa nga temat e mbajtura gjatë konferencës ishin: “Dinamikat e hapësirës dhe kohës”, “Studimet etnografike shqiptare”, “Çështjet e Ballkanit” etj.

Korçë – Kluzh, një bashkëpunim që vazhdon

Në kuadrin e binjakëzimit mes Bashkisë së qytetit të Korçës dhe asaj të Kluzhit (Cluj) në Rumani, një delegacion i përbërë nga Kryetari i Bashkisë z. Niko Peleshi, Kryetarja e Këshillit Bashkiak znj. Rajmonda Nase, Drejtori i Ujësjellës – Kanalizimeve, z. Petrit Tare si dhe disa përfaqësues nga stafi i Bashkisë zhvilloi një vizitë 2 ditore në qytetin e Kluzhit.

Në Bashkinë e qytetit, delegacioni shqiptar u prit nga Nënkrjetari i Bashkisë, z. Janos Boros, Drejtori i Ujësjellës-Kanalizimeve të qytetit si dhe nga një pjesë e stafit. Gjatë takimit, të dy palët u angazhuan për bashkëpunime të mëtejshme në fusha të ndryshme e sidomos në shkëmbime kulturore e ato të turizmit.



Shërbime

Sporteli i informimit qytetar

Në Bashkinë e qytetit është ngritur sporteli i informimit qytetar.

Ky sportel do të përmbushë në mënyrën më të mirë nevojat e qytetarëve, duke synuar t'u japë zgjidhje endjeve të pafund në zyrat e administratës, po kështu administrata do të rritë efektivitetin e saj në punë. Tani qytetarët krahas ambientit komod do të kenë mundësi që të informohen, orientohen mbi problemet apo shqetësimet që kanë. Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve do të gjenden pranë sportelit dhe do të përpunohen në kohën më të shkurtër të mundshme. Në këto sportele qytetarët do të kenë mundësinë për të dhënë mendimin e tyre mbi punën e Bashkisë. Një nga pikat më kryesore në punën e sporteleve është koncepti i trajtimit të qytetarëve si klientë. Duke e parë qytetarin në këtë mënyrë ai merr një rol primar në hartimin, planifikimin dhe vlerësimin e projekteve të Bashkisë.



Karta e Bibliotekës në dorën e lexuesit

Karta e Bibliotekës është simboli i ri i anëtarësimit në Bibliotekën "Thimi Mitko" të qytetit. Nëpërmjet saj është bërë i mundur kërkimi dixhital i titujve të librave. Në këtë mënyrë është lehtësuar për lexuesin gjetja e çdo lloj informacioni të kërkuar që është në fondin e këtij institucioni. Deri tani me këtë kartë janë pajisur më tepër se 450 vetë dhe numri i të interesuarve është në rritje. Kjo kartë u bë e mundur edhe me mbështetjen e Raiffeisen Bank.



Vendime

Disa nga vendimet e mbledhjes së fundit të Këshillit Bashkiak

Datë 25.04.2008

- Për ngritjen e komisionit për verifikimin e pasurive të paluajtshme
- Për vënie në dispozicion trualli për ndërtimin e Kompleksit Medrese dhe Xhami
- Miratim i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për krijimin e subjektit Administrim i Mbetjeve të Qarkut Korçë
- Për bashkëthemelimin e Shoqërisë "Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë"
- Për miratimin e fondit prej 366 000 për shfaqjen e Dramës "Pamje nga ura" nga Trupa e Teatrit Kombëtar
- Miratim fondi prej 100 000 lekë për vlerësimin e ekipit të basketbollit për meshkuj
- Për detajimin e fondit të miratuar me VKB Nr. 12, datë 18.03.2008, për implementimin e projekteve prioritare për vitin 2008
- Miratim fondi për Konkursin Ndërkombëtar të Fotografisë Artistike për të rinj "Sotiri"
- Për dhënie titulli Qytetar Nderi zj. Qefsera Trako

Korça ku → dua të jetoj

Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote.

Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.


Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.



Fotoja e muajit:

“Katedralja” fotografuar nga Pirro Katundi

“

Një nga veprat më të bukura arkitektonike të qytetit: Katedralja “Ringjallja e Krishtit” i jep bukuri qytetit.

Dielli që duket në krahun e majtë të Katedrales s’është gjë tjetër veçse reflektimi i tij në një nga panelet diellore të shtëpive të qytetit.

Fotografuar në një pasdite shtatori.

”

Problematika me syrin e qytetarëve



Nga komentet e dërguara pranë zyrës së informacionit për rubrikën “Fjalën e ke ti” ne kemi shkëputur disa sugjerime të bëra nga ju:

- Ngritja e një këshilli qytetar, me përfaqësues nga qytetaria korçare, me qëllim dhënien e ideve për probleme të ndryshme
- Zëvendësimi i kurorës së gjelbër të qytetit
- Ndëshkimi i atyre që hedhin inerte në koshat grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimi i vendeve rreth koshave
- Ngritja e Muzeut Historik në një nga ndërtesat karakteristike të Korçës
- Përshtatja e arkitekturës tradicionale të disa ndërtesave në qendër të qytetit nga ndërtesa e postës deri tek Mësonjëtorja e Parë
- Sistemimi paraprak i rrugëve tek Mitropolia
- Zgjerimi i rrugës dytësore tek Kolegji Preka

Ne vazhdojmë të marrim komente nga ju dhe ju falenderojmë për këtë. Të gjitha këto sugjerime dhe ide do të vlerësohen nga stafi i Bashkisë dhe do të pasqyrohen në faqet e “Qyteti im”.

Mirëpresim sugjerime të tjera!



Më 5 –Qershor, Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit,

Bashkia Korçë në bashkëveprim me Firmën e Pastrimit të qytetit “Korsel” dhe me kontributin e disa aktorëve të tjerë lokalë si Pro Credit Bank, Eko Shërbimi, SIDA, Ambasadorët e Paqes, Organizata Mjaft dhe Senati Rinor do të hidhën në terren për pastrimin e sipërfaqeve më problematike të qytetit.

Bashkia i fton të gjithë të japin kontributin e tyre për një mjedis më të pastër duke zbatuar detyrat e jetës komunitare.

Ajo kërkon kontributin e drejtpërdrejtë të të gjithëve, rritjen e vetëdijes dhe të përgjegjësisë qytetare në përmirësimin e mjedisit.

Qytetarë!

Çdo veprim sado i vogël individual për mbrojtjen e mjedisit është një investim i madh në ruajtjen e pastërtisë! Le ta konsiderojmë mjedisin rrethues si pjesë të shtëpisë sonë! Në këtë mënyrë duhet të zbatojmë rregullat dhe detyrimet për të përmirësuar cilësinë e jetës.

Fjalën

e ke ti!

Komplimenta **Komente** **Ankesa**

Bashkia të ofron mundësinë të thuash atë që ti mendon mbi shërbimet e ofruara prej saj, sa pranë nevojave tuaja qëndrojnë ato dhe çfarë do të donit të bëhej më mire!

Ju mund të dërgoni **KOMPLIMENTE**,
KOMENTE apo **ANKESA**

Ne kemi marrë përsipër t'ju sigurojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë na duhet mendimi juaj. Nëse kemi bërë një punë të mirë apo jo, ne duam ta dëgjojmë këtë nga ju.

Fjalën e ke ti!

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Dorëzoni formatin e plotësuar pranë Zyrës së Informacionit
"Bashkia Korçë"

Jepni sa më shumë informacion

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Të dhënat tuaja (jo e detyrueshme)

Emër Mbiemër:
Profesioni:
Adresa:
Tel:
e-mail:

Zgjidhni opsionin

- Komplimenta**
 Komente
 Ankesa



Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori

Suplement

Benila Tërova

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës "V.Mio"
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri "A.Z.Çajupi"

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Kristaq Sotir
Orieta Glozheni

Design:

R&T Advertising



Për një qytet ku bashkëjetojnë tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vëshitërsia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një këthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni "Qyteti Im"



Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@albmail.com